

VENDIM
Nr. 335, datë 4.5.2016

**PËR TRANSFERIMIN E 100% TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE AKSIONARE
“REZIDENCA STUDENTORE NR. 1” SHA, TIRANË, “TRAJTIMI I
STUDENTËVE NR. 2” SHA, TIRANË DHE “TRAJTIMI I STUDENTËVE NR. 3”
SHA, TIRANË, NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES TE BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të neneve 3 e 4, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare “Rezidenca studentore nr. 1” sh.a., Tiranë, “Trajtimi i studentëve nr. 2” sh.a., Tiranë, dhe “Trajtimi i studentëve nr. 3” sh.a., Tiranë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes te Bashkia Tiranë, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekono-mik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama